

Caritas Kosova



Raporti Vjetor 2016

Përmbajtja

Kush jemi ne	2
Fjala Hyrëse	3
Përkujdesi Shtëpiak dhe Ambulator	4
Lufta kundër Trafikimit me Njerëz	5
Paqa dhe Pajtimi	6
Mbështetja e Personave me Aftësi të Kufizuara	8
Përfshirja e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian	10
Ushqim për të gjithë	13
Përtej portave të burgut	15
Edukimi i fëmijëve	17
Ekonomia Sociale	18
Intervenimet Emergjente	19
Buxheti Vjetor	20

Kush jemi ne!

Caritas Kosova është institucion i Kishës Katolike në Kosovë misioni i së cilës është promovimi i paqes, solidaritetit, dhe dashurisë në mes të njerëzve. Caritas Kosova është anëtare e Caritas Internationalis (CI) dhe Caritas Europa (CE) që shërben dhe ofron ndihmë për më të varfërit pa dallim race, kombësie, religjioni, etj.

Aktiviteti i Caritas Kosova në vitin 2016, në përputhje me strategjinë ishte zbatimi i programeve dhe projekteve në kuadër të 4 mandateve operacionale: Asistenca Sociale dhe Shëndetësore, Zhvillimi i Qëndrueshëm, Avokimi dhe Lobimi, dhe Asistencë në Emergjencë dhe Rehabilitimi i Qëndrueshëm (në gatishmëri). Nëpërmjet veprimtarive të shumta, jemi përpjekur të jemi në afërsi të atyre që janë në nevojë për të lehtësuar problemet në të cilat ata jetojnë, siç janë varfëria dhe izolimi.

Vizioni

Vizioni ynë është që të promovojmë fuqimisht vlerat e përgjithshme universale, përmirësimin e kushteve të jetës ekonomike dhe sociale të shoqërisë kosovare, përmes veprimeve të fokusuara dhe të vëmendshme ndaj drejtësisë, mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përfshirjen sociale dhe duke u përkushtuar kryesisht ndaj njerëzve në nevojë dhe atyre më të marginalizuar.

Duke u ballafaquar me shumë çështje në Republikën e Kosovës, ku ndër problemet më të mëdha është papunësia (27.5%) si dhe varfëria ekstreme (15%) që janë rrënja e shumë problemeve në shoqëri "Si Caritas Kombëtar, ne mobilizojmë të gjitha mundësitë për të ofruar ndihmë për ata që kanë nevojë sepse dinjiteti njerëzor dhe të drejtat e tij janë të paprekshme, kjo është dhurata e Zotit e garantuar për çdo individ" - Don Viktor Sopi

Të nderuar Partnerë dhe miq të Caritas Kosova, në këtë raport vjetor gjeni informacion mbi aktivitetet e zbatuara në mbështetje të personave në nevojë në vitin 2016.

Të dashur bashkëpunëtorë dhe partnerë të Caritas Kosova!



Caritas Kosova si institucion bamirësie në vend korrespondon me Caritaset Europiane dhe Caritaset fqinje, ku me theks të veçant analizon dhe mediton për gjendjen e qytetarëve në vendin tonë si dhe mundësitë për të qenë në shërbim të tyre.

Gjendja në të cilën është katandisur bota e dakadave të fundit, ku jetën e kanë përfshirë ritet e egra dhe një konglumerat i paparë, flet për një funksionim jo të mirë dhe defektoz të sistemit të vlerave shoqërore, duke dëftuar çrregullime pothuajse në të gjitha proceset e jetës. Prandaj,

në epiqendër të veprimit Caritasi ka ofrimin e ngrohtësisë njerëzore dhe veprës konkrete përmes projekteve të shumta kundrejt të gjitha kategoritve të shoqërisë.

Përvoja e mos ngopjes me të mirat e përkohshme e orienton njeriun përtej atyre!

Njeriu, qenie e kualifikuar si **Homo Viator**, në udhëtim drejt qëllimit të caktuar, si i tillë gjendet në: **In Statu Viae**, në një proces të vazhdueshëm zhvillimi.

Gjatë këtij udhëtimi njeriu është "i mbrojtur" dhe "i porositur" nga disa norma.

Në dialog me krijuesin e tij njeriu zbulon veten, sepse Hyji hyn në jetën e njeriut duke pyetur: "Ku Je?" (Zan 3.9), për të vazhduar më tej: "Ku është vëllau yt...?" (Zan 4.9).

Këto pyetje egzistenciale ngërthejnë konceptin e përgjegjësisë së Caritasit, prandaj thërras mendjen dhe zemrën e çdo punonjësi të Caritasit që të jetë ngrohtësi dhe zemër njerëzore ndaj të afërmit që e thërret përkushtimi karitativ.

Një falënderim të veçant shprehim ndaj të gjithë donatorëve, në veqanti vigjilencës së faktorit vendor, që me komponentën sociale sado pak zbërthen dhe zbaton konceptin karitativ për njeriun e kësaj hapësire.

Zoti Ju Bekoft,

Don Viktor Sopi - Drejtor Gjeneral

Përkujdesi Shtëpiak dhe Ambulator

Përkujdesi Shtëpiak - Duke përdorur modelin e Përkujdesit Shtëpiak Gjerman dhe me mbështetjen e Caritasit Gjerman, Ministrisë dhe Komunitat, Caritas Kosova ka zbatuar programin e Përkujdesit Social dhe Shëndetësor në shtëpi. Ky program është zbatuar në 12 komunitet ku përfitues janë personat më të cenueshëm dhe të vetmuar, të moshuar dhe të braktisur, personat me

aftësi të kufizuara dhe të sëmurët mendorë, pavarësisht nga besimi, etnia dhe gjinia e tyre. **Mbi 1200 përfitues** kanë përfituar përmes këtij programi duke pranuar shumë shërbime bazë. Caritas Kosova mbetet e vetmja organizatë që ofron një shërbim të tillë në Kosovë. “Me vizitën dhe mbështetjen tuaj, jeta ime ka kuptim” janë fjalët e një përfituesi të moshuar në Drenas.



“Me vizitën dhe mbështetjen tuaj, jeta ime ka kuptim” janë fjalët e një përfituesi të moshuar në Drenas.

Përkujdesi Ambulator -

Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunitat, gjatë kësaj periudhe Caritas Kosova ka zbatuar Përkujdesin Ambulator në 12 Komuna. Përmes këtij projekti Caritas Kosova në bashkëpunim me partnerët institucionalë ka arritur të funksionalizojë

86 Qendra Mjekësore në zonat rurale dhe fshatra. Të angazhuar në këtë program ishin **85 mjekë, 24 stomatologë dhe mbi 300** infermiere që ua mundësojnë shërbimin mjekësor qytetarëve jo më larg se 4 km nga ku jetojnë. Të dy komponentët e plotësojnë njëra tjetrën duke ofruar një shërbim unik.

Partnerët: Caritas Germany, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Caritas Switzerland, Komunitat: Ferizaj, Rahovec, Viti, Gjiilan, Mitrovicë, Hani i Elezit, Drenas, Istog, Fushë Kosovë

Lufta kundër Trafikimit me Njerëz

Mbi 16,800 fëmijë kanë përfitur në mënyrë indirekte nga trajnimet e mësuesve!

Që nga viti 2006, Caritas Kosova është e përfshirë në mënyrë aktive në luftën kundër trafikimit me njerëz. Fenomeni i trafikimit të qenieve njerëzore është një plagë serioze që ka prekur njerëzimin në të gjitha kohërat, Caritas Kosova është e angazhuar ta parandalojë këtë fenomen me një fokus të veçantë tek fëmijët dhe gratë. Ekzistojnë 3 komponentë të këtij programi, Parandalimi, Ngritja e Ndërgjegjësimit dhe Riintegrimi i suksesshëm i Viktimave (Potenciale) të Trafikimit. Në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar dhe si anëtarët e Grupit Ndërmintor, Caritas Kosova ka realizuar trajnime të stafit të shkollave fillore në 3 komuna (Ferizaj, Viti, Mitrovicë), ku janë trajnuar mbi 70

mësimdhënës për të identifikuar dhe referuar në institucionet kompetente fëmijët që kanë shenja trafikimi si: abuzimi, kërkim lëmosha dhe puna e detyruar. Mbi 16,800 fëmijë kanë përfitur tërthorazi nga këto trajnime. Përveç kësaj, Caritas Kosova ka realizuar një hulumtim mbi Nivelin e Ndërgjegjësimit të fenomenit TQNJ, rezultatet dhe rekomandimet e të cilit janë prezantuar gjatë Konferencës Vjetore për Trafikimin e Qenieve Njerëzore. Për më tepër, në kuadër të procesit të riintegritimit, Caritas Kosova ka filluar procesin e zbatimit për **3 përfitues**, duke ofruar 6 muaj trajnim profesional, si dhe shpërndarjen e ndihmës humanitare për **10 viktima të mitura të trafikimit**.

Partnerët: Secours Catholique - Caritas France, Catholic Relief Services



Paqa dhe Pajtimi

Në rajonin e Mitrovicës, në përputhje me rrethanat ekonomike, sociale dhe politike në vend, Caritasi ishte i angazhuar në promovimin e paqes dhe pajtimt ndëretnik në mes të komuniteteve që jetojnë në këtë rajon. Kjo është arritur nëpërmjet përfshirjes sociale të grupeve të marginalizuara, sidomos të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, Promovimit të Drejtave të Njeriut si dhe mbështetja në aspektin e zhvillimit ekonomik. Nëpërmjet projektit Përfshirja Sociale

e Fëmijëve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Mahallën e Romëve, janë ofruar 60 vizita me qëllim të përmirësimit të kushteve zhvillimore dhe mirëqenies për 67 fëmijë të moshës 3 deri në 10 vjeç. Përveç kësaj, projekti ka siguruar qasje në shërbimet publike për fëmijët më të cënueshëm. Nëpërmjet projektit Arsimiti intensiv për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, Caritasi synon të sigurojë një integrim më të mirë të komuniteteve përmes arsimit jo formal.

20 përfitues kanë përfunduar nivelin e planifikuar të arsimit dhe kanë marrë diploma.





Në kuadër të projektit Forcimi i Ekonomisë Rurale dhe Mundësive të Biznesit Vendor në komunën e Leposaviqit dhe Mitrovicë (SELO) qëllimi i të cilit është parandalimi i izolimit social të grupeve të marginalizuara rurale: të papunëve, grave dhe të rinjve; rigjallërimin dhe zhvillimin e zonave rurale të Rajonit të Kosovës Veriore (bashkësitë etnike serbe dhe shqiptare), gjithsej 31 fermerë kanë përfituar nga skema e granteve të përshtatura. Përveç granteve, këto kapacitete të fermerëve janë zhvilluar përmes pjesëmarrjes në vizitat studimore kombëtare dhe rajonale, panairë dhe ngjarje të projektit. Përveç aktiviteteve të planifikuara brenda programit, Caritasi ka zbatuar aktivitete të shumta që janë komplementare dhe në lidhje me programin, si: dita ndërkombëtare e bamirësisë, vullnetarizmi, dhjetë milionë yje, dita ndërkombëtare e paqes etj.

Nëpërmjet **Programit Kombëtar të Animitit**, Caritasi ka përfshirë në aktivitetet e saj një numër të madh të vullnetarëve të cilët janë vazhdimisht të trajnuar dhe të përgatitur për të kontribuar për njerëzit në nevojë. Për shkak të nevojës së madhe për kornizën ligjore që rregullon vullnetarizmin, Caritas ka lobuar tek institucionet relevante për miratimin e ligjit për vullnetarët.


Në 2016: 60 vullnetarë janë trajnuar për të kryer aktivitete të animacionit me të rinjë dhe fëmijët; 10 vullnetarë të famullisë kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme me të burgosurit e mitur; Mbi 700 fëmijë dhe 120 vullnetarë morën pjesë në ngjarje të veçanta (10 milion yje dhe ditën e vullnetarëve); 60 vullnetarë të famullisë u angazhuan për shpërndarjen e ndihmave humanitare për familjet e varfëra.

Mbështetja e Personave me Aftësi të Kufizuara

Arsimi profesional në qendrën e dëgjimit dhe të folurit të dëmtuar - Si në të kaluarën, Caritas Kosova është shumë aktive për të lehtësuar jetën për personat me aftësi të kufizuara. Në vitin 2016, Caritas Kosova ka siguruar makina për përpunimin e kartonit dhe ka ofruar trajnime për të njëjtën gjë, në Qendrën për fëmijët me dëgjim dhe të folur të dëmtuar në Prizren. Kjo qendër numëron rreth 90 fëmijë nga niveli fillor, niveli i mesëm i ulët dhe arsimi i mesëm ose profesional. Në nivelin e mesëm të lartë nëntë fëmijë kanë përfituar nga ky program i përpunimit të kartonit dhe kanë fituar mundësi më të mira për të hyrë në tregun e punës pas përfundimit dhe certifikimit.

Përkujdesi dhe edukimi i hershëm për fëmijët me aftësi të kufizuara (0-6 vjeç) - Caritas Kosova ka investuar

në rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara për fëmijët me autizëm në Qendër duke ofruar ngritjen e kapaciteteve të personelit të përfshirë. Kështu, dy psikologë që punonin në Qendrën për kujdes të hershëm dhe edukim për fëmijët me aftësi të kufizuara morën pjesë në një trajnim 3 mujor në Tiranë rreth Analizës së Aplikuar të Sjelljes (ABA). Psikologët që kanë përfunduar trajnimin janë certifikuar zyrtarisht nga shteti dhe Fondacioni që ka ofruar trajnimin. Qendra e kujdesit dhe edukimit të hershëm numëron 45 fëmijë me aftësi të kufizuara të ndryshme si dhe prindërit e tyre, si përfitues direkt. Përveç aktiviteteve të përditshme mësimore, sociale dhe fizike të ofruara në qendër, një veprim i rëndësishëm është regjistrimi i fëmijëve në sistemin e rregullt shkollor si pjesë e strategjisë së re të përfshirjes.





Rezultati i angazhimit tonë në vitin 2016 është se ne kemi arritur të regjistrojmë tetë fëmijë me aftësi të kufizuara në programin e rregullt parashkollor dhe shkollor.

SOCIETIES / Mbështetja e OSHC-ve në fuqizimin e aftësive teknike, përfshirja e personave me aftësi të kufizuara dhe standartet e BE-së në Evropën Juglindore - Caritas Kosova është antare e 15 organizatave të tjera nga Evropa Lindore dhe Italia që bashkërisht po implementojnë projektin SOCIETES. Faza e parë e projektit u përqendrua në krijimin e hartës së OJQ-ve dhe analizimit të kapaciteteve të tyre në fushën e aftësisë së kufizuar dhe

shëndetit mendor me qëllim identifikimin e nevojave dhe kapaciteteve të tyre. Caritas Kosova identifikoi 23 OJQ aktive. Në dhjetor 2016, Caritas ka lansuar thirrjen për nën-grante për OJQ-të e përmendura. 4 OJQ do të përfitojnë nga këto grante, më pas klientët e tyre janë përfituesit përfundimtarë. Në dhjetor 2016, Caritas Kosova ka nisur një projektin “Së bashku për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar” të mbështetur nga GIZ (Organizata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtarë) me konferencën më 3 dhjetor duke shënuar Ditën Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar.



Partnerët: Unioni Evropian, Caritas Innsbruck, Caritas Italiana, Caritas Czech Republic, Ambasada e Qekise, GIZ

Përfshirja e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian

Janë përkrahur 200 fëmijë të shkollës fillore në programin e mësimit plotësues.

Caritasi punon intenzivisht në zhvillimin e projekteve për të përkrahur përfshirjen sociale të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në shoqërinë kosovare, me theks të veçantë në përmirësimin e mirëqenies sociale dhe ekonomike të këtyre komuniteteve. Duke u bazuar në gjendjen e rëndë socio-ekonomike, arsimore dhe kulturore të këtyre komuniteteve, Caritas Kosova ka fokusuar aktivitetet e saja në katër komponentë kryesorë, në Edukim, Kulturë, Shëndetësi dhe Asistencë Sociale. Përkundër intervenimit në shumë fusha këto komunitete vazhdojnë të

përballen me probleme të mëdha, sidomos me papunësinë, mos përfshirjen, segregimin, infrastrukturën e pakët, etj. Përmes Qendrës Sociale-Edukative të Caritasit në Dubravë të Ferizajt janë përkrahur 200 fëmijë të shkollës fillore në programin e mësimit plotësues. Ky program synon të fuqizoj njohuritë e fëmijëve të komunitetit, të rrisë aktivitetin dhe përfshirjen e tyre në shkollë, të parandaloj braktisjen dhe mungesat, si dhe të fuqizojë raportet sociale. Përveq mbështetjes në lëndët shkollore 10 fëmijë kanë përfunduar kursin e gjuhës angleze.



Rreth 60 fëmijë të moshës nga 3 deri në 6 vjeç kanë frekuentuar Qendrën në edukimin Parashkollorë. Në kuadër të komponentës kulturore është shënuar dita ndërkombëtare e fëmijëve. Piktori ndërkombëtar Anook la shenjat e tija në Qendër me portretet e fëmijëve. Në bashkëpunim me vullnetarët e Caritasit është shënuar aktiviteti tradicional "10 milion yje" si dhe janë zhvilluar vizita informuese në: Asambleen Komunale në Ferizaj, Shtëpinë e Kulturës, Komandën e Doktrinës dhe Stërviçes në Ferizaj, Stacionin e Zjarrëfikësve, etj.

Në Ambulantën e Qendrës gjatë tërë vitit janë ofruar shërbime të mjekësisë primare dhe shërbime të stomatologjisë, pa pagesë. Në vitin 2016 janë ofruar 4988 shërbime të mjekësisë primare si dhe 958 shërbime stomatologjike.

Në Qendrën e Komuniteteve të menaxhuar nga Caritasi në lagjen Ali Ibra në Gjakovë 140 fëmijëve iu janë ofruar shërbime edukative dhe aktivitete psiko-sociale, në baza ditore.

40 fëmijë të moshave 4 deri në 6 vjeç kanë ndjekur edukimin parashkollor. Ndërsa 85 fëmijë të shkollave fillore kanë vijuar programin e mësimin plotësues. Në një program të veçantë është punuar me 15 fëmijë të cilët kanë braktisur shkollën, me qëllim të përgatitjes së tyre për t'i rikthyer në bankat shkollore. Në vitin 2016, 40 fëmijë kanë vizituar Stacionin Policor të Gjakovës si dhe kanë shënuar Ditën Ndërkombëtare të fëmijëve, Ditën e Paqes si dhe festa të tjera duke shprehur talentin e tyre në recitim, vizatim, vallëzim si dhe shkrimin e poezive. 30 të rinj nga kjo lagje në mënyrë të rregullt kanë marrë pjesë në aktivitetet sportive në nivel komunal.

Në kuadër të Qendrës janë ofruar edhe shërbime shëndetësore si pjesë e projektit 'Home Care' për rreth 60 të moshuar. 115 persona të moshës 0-18 vjeç janë vaksinuar në Qendër në bashkëpunim me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Gjakovë.





Fokus i veçant i është kushtuar të rinjëve të cilët janë trajnuar dhe ftuar në puntori të ndryshme me qëllim të përgaditjes së tyre për punë. **Nga 50 të rinj sa kanë marrë pjesë në këtë aktivitet 6 janë punësuar në kompani private në Gjakovë.**

Gjatë vitit 2016, zyra regionale e Caritas Kosova në Mitrovicë ka zhvilluar projektin e pëfshirjes sociale të fëmijëve dhe të rinjve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në bashkëpunim me shkollat fillore në Mitrovicë, Institucionet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, Institucionet Shëndetësore, si dhe Qendrën për mirëqenie sociale dhe autoritetet komunale të arsimit. Projekti synon përfshirjen e fëmijëve në sistemin e rregullt të arsimit dhe shëndetësisë dhe sigurimin e kushteve optimale për arsim.

Në këtë aktivitet të Caritasit kanë përfituar 150 fëmijë dhe 300 prindër. Projekti i "Edukimit intenziv" i përkrahur nga DRC dhe implementuar në partneritet të ngushtë me Departmentin Komunal për Edukim dhe Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ka siguruar arsimin fillor për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Mahallën e Romëve sipas ligjit në fuqi. 12 të rinj të përkrahur në shkrim-lexim përmes kurseve i janë nënshtruar testit të ditursë nga Ministria e Arsimit dhe janë certifikuar. Të lartpërmendurit kanë shërbyer si shembull për bashkëmoshatarët e tyre dhe kanë ndihmuar në promovimin e vlerës së arsimit për shoqërinë kosovare në përgjithësi dhe komunitetet pakicë në veçanti.

12 të rinj të përkrahur në shkrim-lexim përmes kurseve i janë nënshtruar testit të ditursë nga Ministria e Arsimit dhe janë certifikuar.

Partnerët: Caritas Switzerland, Secours Catholique - Caritas France, Komunitat: Ferizaj, Gjakova dhe Prizreni, Unicef, DRC, Terres Des Hommes

Ushqim për të gjithë

Mbi 500 familje, që jetojnë në varfëri ekstreme janë përkrahur nga Caritasi me ushqim, veshëmbathje dhe mobile të ndryshme

Shumë persona janë ndihmuar në bashkëpunim me Kishën Katolike, Institucione shtetërore dhe Organizata që veprojnë në Kosovë.

Ky aksion është zhvilluar me: Famullitë, Kuvendet e motrave të nderit, Mensa për të varfër në Prishtinë, Çerdhet e fëmijëve, Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (Ferizaj, Gjilan, Istog, Viti), Instituti Special në Shtime, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Drenas, Qendrat për Punë Sociale (Hani Elezit, Viti), Shkollat, Strehimorja në Gjilan, Handikos Ferizaj, Shoqatat e pensionistëve (Ferizaj, Shtërpç, Shtime,

Suharekë), Klubet sportive, Qendra për mbrojtjen e fëmijëve dhe grave (Ferizaj, Reçak), SOS fshati, Shoqata e të plagosurve civil nga minat në Shtime, etj. Po ashtu janë ndihmuar përfituesit e projekteve të Caritasit - Qendra Sociale Edukative 'Caritas Kosova' në Dubravë dhe lagjen Ali Ibra në Gjakovë, Qendra për edukim të hershëm në Prizren, Home Care (Drenas, Fushë Kosovë, Gjilan, Istog, Klinë, Mitrovicë, Prishtinë, Prizren, Viti), etj.

Partner strategjik janë vullnetarët e organizatës gjermane "Junge Leute Helfen"

Në vitin 2016 Caritas Kosova ka shpërndarë 170 ton nidhma humanitare me vlerë monetare prej 50,000.00€



Në përputhje me angazhimin e Caritas Internationalis për “Fundin e Urisë” në botë dhe strategjinë e Caritas Kosova, ne kemi vazhduar të sigurojmë ushqim për grupet më të rrezikuara në veri të Kosovës, posaçërisht Komunitatet Lepsaviq, Zveçan, Zubin Potok, Mitrovicë, Novobërd dhe Graçanicë.

93 persona përfituan nga ky program duke marrë pajisje për bletari dhe bujqësi. Përveç përfitimit nga mini-grantet, përfituesit janë dërguar edhe në vizitën e përbashkët studimore në një panair të ushqimit tradicional në Beograd, si dhe në sesionet e shumta të informimit dhe trajnimit për ngritjen e kapaciteteve.



93 persona përfituan nga ky program duke marrë pajisje për bletari dhe bujqësi.

Përtej portave të burgut

Të burgosurit në Kosovë vazhdojnë të jenë kategori tejet e cënueshme dhe e pa trajtuar nga institucionet dhe shoqëria. Për të trefin vit Caritasi ka përkrahur në mënyrë direkte këtë kategori, në mënyrë të veçantë gratë dhe të miturit e burgosur. Në këtë vit janë trajnuar dhe certifikuar 12 gra të burgosura, shtatë në floktari dhe pesë në rrobaqepësi. Me këtë trajnim dhe certifikatën e lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale sigurohet një mundësi më shumë për ri-integrim të suksesshëm pas lirimit. Po ashtu janë zhvilluar aktivitete sportive në mes të të miturve të burgosur dhe bashkëmoshatarëve të tyre që janë

vullnetarë të Caritas Kosova.

Për të ndërgjegjësuar shoqërinë për rëndësinë e trajtimit dhe ri-integrimit të të burgosurve, dhe për të promovuar të drejtat e tyre, Caritasi ka prodhuar filmin dokumentar 'Përtej Portave'.

Tre të burgosur shpalosin tregimet e tyre të jashtëzakonshme, përvojat dhe ëndrrat për të ardhmen.

Në fund të vitit është organizuar konferenca përmbyllëse për prezantimin e rezultateve të projektit. Pjesë e konferencës së organizuar në Kino ABC ishte edhe premiera e filmit dokumentar.

Janë trajnuar dhe certifikuar 12 gra të burgosura



“ Caritasi ka prodhuar filmin dokumentar ‘Përtej Portave’. Tre të burgosur shpalosin tregimet e tyre të jashtëzakonshme, përvorjat dhe ëndrrat për të ardhmen. ”



Partner: Secours Catholique - Caritas France



Edukimi i fëmijëve



Si edhe në të kaluarën, në vitin 2016 Caritas Kosova u angazhua në ofrimin e shërbimit më të mirë të mundshëm dhe të edukimit cilësor në Kopshtin tonë në Ferizaj. Kopshti ynë ka ofruar shërbimet e kujdesit për mbi 250 fëmijë të moshave 6

muaj deri në 6 vjet. Ky Kopsht i licencuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, është një nga kopshtet më të mira në Kosovë, me hapësirën mbi 1000 m² dhe i pajisur me mobiljet adekuate.

Partner: Komuna e Ferizajit





Konferenca ndërkombëtare: "Ekonomia Sociale: Perspektivë Evropiane për Zhvillimin e Territoreve dhe Komuniteteve"

Ekonomia Sociale

Caritas Kosova në vazhdimësi promovon ekonominë social si qasje inovative dhe mekanizëm efikas për zvogëlimin e varfërisë si dhe për të përkrahur përfshirjen sociale dhe punësimin. ELBA (Emergency Labour in Balkans) është një iniciativë e projektuar për t'iu përgjigjur krizës ekonomike në Evropën Juglindore dhe pjesë të këtij projekti janë: Kosova, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Greqia, Mali i Zi, Serbia dhe Maqedonia. Ekonomia sociale njihet si një mënyrë për të angazhuar dhe për të fuqizuar të gjithë shoqërinë, sektorin publik si dhe sektorin privat, nga organizata fitimprurëse tek organizatat jo-fitimprurëse, nga territoret tek komunitete, për të zhvilluar një model të ri ekonomik që përfshin njerëzit në nevojë si burim aktiv i shoqërisë.

Në takimin final të fazës së parë të projektit të organizuar në Prishtinë është mbajtur punëtorja: "Nga përvoja e ELBA 1 tek idetë e ELBA 2" si dhe konferenca ndërkombëtare: "Ekonomia Sociale: Perspektivë Evropiane për Zhvillimin e Territoreve dhe Komuniteteve". Në këto dy ngjarje kanë prezantuar rreth 50 pjesëmarrës nga Rajoni dhe Evropa të cilët kanë prezantuar modele të ekonomisë sociale nga vendet respektive. Caritas Kosova ka përkrahur financiarisht dhe ka themeluar tri ndërmarrje sociale të cilat kanë punësuar 10 persona me orarë të plotë.

Ndërmarrja sociale We do it 4 you ofron shërbime të pastrimit dhe kujdesit ditorë, La Text është një sallon rrobaqepësie dhe Made for You është dyqan dhuratash.

Partnerët: Konferenca Ipeshkvore Italiane dhe Caritas Italiano

Intervenimet Emergjente

Në korrik 2016, Caritas Kosova mori pjesë në takimin vjetor në kuadër të SEECEG (Grupi i Emergjencave të Caritasit nga Evropa Juglindore). Takimi u prit nga Caritasi Polak dhe u organizua nga Caritas Europa. Qëllimi i takimeve vjetore është azhurnimi i vazhdueshëm i organizatave anëtare

për veprimet emergjente dhe rehabilituese të ndërmarra në vitin përkatës, si dhe veprimet e përbashkëta në ndërhyrjet emergjente. Çdo vit një kryetar i grupit zgjedhet për një mandat njëvjeçar. Aktualisht përfaqësuesi i Caritas Kosova mban postin e kryetarit për SEECEG.



Përfaqësuesi i Caritas Kosova është duke mbajtur pozitën e udhëheqësit të SEECEG.

Buxheti Vjetor

2,361,889.77 €

Përkujdesi Shtëpiak dhe Ambulator

1,294,887.01 €

Lufta kundër Trafikimit me Njerëz

51,732.48 €

Paqa dhe Pajtimi

93,975.00 €

Mbështetja e Personave me Aftësi të kufizuara

109,474.86 €

Përfshirja e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian

225,855.64 €

Ushqim për të gjithë

200,409.84 €

Përtej Portave të Burgut

29,580.00 €

Edukimi i Fëmijëve

232,793.00 €


Ekonomia Sociale

32,664.82 €


Intervenimet Emergjente

90,517.12 €

Përqindja sipas donatorëve



Përqindja sipas programit



Zyra Qendrore - Ferizaj

rr. Shën Nënë Tereza nr. 3,
70000, Ferizaj, Kosovë
tel. +381 (0)290 328 110
fax. +381 (0)290 396 588
e-mail: info@caritaskosova.org

Zyra Regjionale - Prishtinë

Kisha Katolike, rr Karposh nr. 41
Ulqianë
10000 Prishtinë, Kosovë

Zyra Regjionale - Mitrovicë

rr. Tirana nr. 101
40000 Mitrovicë, Kosovë
tel. +381 (0)28 530 250

Zyra Regjionale - Prizren


rr. Papa Gjon Pali II nr. 1
20000 Prizren, Kosovë
tel. +381 (0)29 244 875

Zyra Regjionale - Gjakovë

Caritas Kosova
Qendra e Komuniteteve Ali Ibra,
50000 Gjakovë, Kosovë

Zyra Regjionale - Leposaviq

Vojske Jugosllavije 16,
43500 Leposaviq, Kosovë
tel. +381 (0)28 84 274



www.caritaskosova.org

<https://www.facebook.com/Caritas.Kosova>